REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 2-180/1644
Nr. i fax. 2
Data 06/03/2026

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës
Nr. 002/18
Datë: 27.02.2026

Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e dytë të rregullt të mbajtur më datë 27.02.2026, pas shqyrtimit të propozimit për lejimin e mjeteve financiare per kompenzimin e komiteteve tjera, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), nenin 51, paragrafi 51.2, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, 14 dhe 15 të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2020, për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, nenin 21, shkronja (h), nenin 22, paragrafi 22.1, pika 4, nenin 39, nën-paragrafi 39.1 të Statutit të Komunës së Junikut, miratuar më datë 29.09.2010, nxjerr këtë:

VENDIM

për aprovimin e kompensimit të anëtarëve të komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës

1. Për aprovimin e propozimit të datës 27.02.2026, për lejimin e mjeteve financiare për kompensimin e anëtarëve të komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës së Junikut, në shumën e mjeteve financiare prej: 150.00€ për mbledhje për secilin anëtar të komiteteve tjera, për gjashtë mbledhje brenda vitit fiskal.

2. Shuma e mjeteve financiare e përshkruar në paragrafin 1 të këtij vendimi ndahet nga buxheti i Komunës së Junikut, kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve – kodi programor Nr. 169 Zyra e Kuvendit Komunal dhe ka për qëllim kompensimin e anëtarëve të komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës, në shumën e lejuar të mjeteve financiare prej: 150.00€ për anëtar për secilën mbledhje të këtij komiteti.

3. Kryerja dhe mbikqyrja e procedurave të tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe sigurimi i mjeteve financiare, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

4.Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës së Junikut.

Akti i dorëzohet:

1. Kryetarit të Komunës;
2. Kryesuesit të Kuvendit të Komunës;
3. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;
4. Udhëheqësit të Personelit dhe
5. Arkivit.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Leonard Llolluni